

## **RAPORTI I PERFORMANCËS TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT, SHTATOR 2022**

### **Deklarata e Rishikimit të Pavarur**

Iniciativa Për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), si drejtuese operationale e Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-PMF), ofron mbështetje për kryerjen e një procesi vetë vlerësimi të matjes së performancës, sipas kërkesës. Kjo mbështetje përfshin kryerjen e rishikimeve të pavarura (IR) të draft-raporteve të vlerësimit. Një kërkesë për një rishikim të tillë është përcjellë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në prill 2022.

Ky Raport i PMF-së së KLSH-së (SAI-PR) është përgatitur nga Znj. Aulona Jani, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Performancës, njëkohësisht drejtuese e ekipit të vlerësimit, Znj. Xhuljeta Çelaj, audituese në Departamentin e Auditimit të Performancës, Z. Koço Sokoli auditues në Departamentin Juridik dhe Zbatimit të Standardeve e Etikës, Znj. Elisa Metaj specialiste në Sektorin e Marrëdhënive me Jashtë, Komunikimit dhe Botimit si dhe Z.Redi Ametllari auditues në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit. Të pestë anëtarët e ekipit u trajnuan për metodologjinë e PMF-së përpara kryerjes së procesit të vlerësimit.

Në përputhje me metodologjinë e rekomanduar të PMF, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka pranuar draft raportin për shqyrtim dhe vlerësim zyrtar me qëllim që të garantohet saktësia dhe objektiviteti i raportit, si i bazuar në fakte. Një grup i brendshëm rishikimi, që nuk ishte pjesë e ekipit të vlerësimit, i përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm, Shefi i Kabinetit dhe drejtorët e departamenteve shqyrtuan draft raportin përpara se ta dorëzonin raportin në IDI, për një rishikim të brendshëm, të pavarur. Vlerësimi u bazua në versionin e miratuar të Kornizës së Matjes së Performancës për SAI-et, PMF 2016 (Botuar më 24 shkurt 2017/Ndryshuar më 5 shtator 2017).

Vlerësimi i Pavarur i kryer nga IDI u kryesua nga Z. Brighton Nyanga, menaxher, Departamenti për Qeverisjen e SAI-ve në IDI, i cili duke mos pasur asnjë përgjegjësi në përgatitjen e Raportit të Performancës konsiderohet të ketë njohuritë dhe përvojën e duhur për të kryer këtë detyrë. Ky rishikim i pavarur kishte si objektiv për të siguruar se ishte respektuar metodologjia e përdorur për Kornizën e Matjes së Performancës, se evidencat qenë të mjaftueshme për saktësinë e pikëzimit të treguesve dhe se analiza në tërësinë e raportit ishte në përputhje me evidencat mbështetëse.

Rishikimi arriti në përfundimin se të gjitha objektivat për një vlerësim të cilësisë janë përmbushur, referuar Raportit përfundimtar të muajit shtator 2022. Për të arritur në këtë përfundim, rishikuesi i pavarur u mbështet në proceset e kontrollit të cilësisë së ekipit të vlerësimit dhe proceset e sigurimit të cilësisë të KLSH-së, të cilat synonin të garantonin se faktet mbi të cilat bazohen përfundimet janë të besueshme dhe të sakta. Të gjitha çështjet e rëndësishme të ngritura gjatë procesit të rishikimit të pavarur, janë trajtuar në mënyrë të përshtatshme në këtë version të Raportit të Vetëvlerësimit të Performancës së KLSH-së.

**Përgatitur nga: Brighton Nyanga**

**28 shtator 2022**